

SISTEMIMI NË SHKOLLË SIGURIA FAMILJARE PRINDËRIT U NDIHMOJNË FËMIJËVE TË RUHEN, TË JENË TË LUMTUR DHE TË MËSOJNË



PËRKUJDESUNI PËR SIGURINË E FËMIJËS SUAJ NË SHTËPI DHE NË RRUGË

AKSIDENTET

Sipas Këshillit për Parandalimin e Aksidenteve të Fëmijëve (2006) [Child Accident Prevention Trust], në Mbretërinë e Bashkuar çdo vit si pasojë e aksidenteve dërgohen në departamentet e aksidenteve dhe të urgjencës së spitaleve rreth dy milionë fëmijë.

KËSHILLAT KRYESORE PËR PARANDALIMIN E AKSIDENTIVE

- Ndhimoheni fëmijën tuaj që t'i kuptojë rreziqet përreth tij.
- Shtrojini fëmijës suaj pyetje se si i ka kuptuar çështjet e sigurisë, për shembull si të kalohet rruga pa u rrezikuar.
- Përkujdesuni që të kryeni kontrole të rregullta të sigurisë në shtëpinë tuaj.
- Kërkoni këshilla për sa i përket sigurisë në shtëpinë tuaj dhe në rrugë.
- Shikoni që fëmija juaj t'i njohë shtigjet e shpëtimit në rast rreziku dhe që di ta thërrasë me telefon numrin 999 në raste të urgjencës.
- Përdorni xhama të sigurisë që janë ose të forcuara, ose të shtresëzuara.
- Përkujdesuni që në secilin kat të shtëpisë suaj të funksionojë sistemi i alarmit kundër zjarrit.
- Mos lini pengesa në korridore dhe mësojeni fëmijën tuaj që t'i mbledhë lodrat e veta.

KONTROLLET E SIGURISË NË SHTËPINË TUAJ

- Identifikojini zonat e rrezikshme në shtëpinë tuaj
 - qilimat e pangjitur
 - mungesa e rrjetës mbrojtëse rreth oxhakat
 - prizat elektrike boshe që nuk janë të mbyllura me kapakë të sigurisë
- Shënojin rreziqet në një listë
- Gjeni zgjidhjet për t'i mënjeluar ato
 - si t'i bëni qilimat të sigurt
 - ku ta bleni rrjetën mbrojtëse të oxhakat

MASAT PARANDALUESE

- Kontrolloni rregullisht nëse lodrat kanë qoshe të thyera ose të mprehta.
- Gjeni lodra që i përshtaten moshës dhe nivelit të fëmijës tuaj.
- Shikoni që lodrat dhe pajisjet të mbajnë shenjën e Institutit Britanik të Standardeve [British Standards Institute].
- Shikoni që t'i largoni litarët e grisur dhe kabllot vazhduese ku mund të ngatërroheni.
- Pajisjet elektrike dhe të gazit duhet të kontrollohen rregullisht nga mjeshtrit përkatës.
- Mbajini thikat e mprehta në vende të paarritshme.

- Substancat zbardhuese, pastruesit shtëpiakë dhe ilaçet duhet të mbahen në vende të paarrishme ose në dollapë të mbyllur.
- Nëse ilaçet duhet të ruhen në frigorifer, shikoni që ato të ruhen në një vend të sigurt në pjesën e prapme.
- Ruajini gjësendet e tualetit dhe kozmetikën në vende të sigurta.
- Vendoseni alkoolin në vende të paarrishme.

NË KOPSHT

- Shikoni që gardhi dhe dyert e kopshtit të jenë të siguruara.
- Përkujdesuni që të gjitha pellgjet dhe fuçitë me ujë të jenë të prapsura ose të mbuluara.
- Nëse është e mundur, ruajini veglat e kopshtit në një vend të mbyllur.
- Nëse keni garazh ose hangar, mbajini dyert të mbyllura.
- Disa shkurre dhe bimë janë të rrezikshme – këshillohuni me departamentin tuaj lokal të parqeve.

NË MAKINË

- Nëse keni makinë, bëjani rregullisht kontrollin teknik.
- Përdorini gjithmonë ulëset për fëmijë dhe shikoni nëse i përshtaten madhësisë së fëmijës tuaj.
- Kujdesuni që fëmija juaj të jetë i lidhur me rripat e sigurimit.
- Kujdesuni që dyert e të gjitha makinave me të cilat udhëtoni të jenë të pajisura me siguresa për fëmijë.
- Fëmijët nuk duhet të rrinë në këmbë e as të udhëtojnë në sektorin e valixheve.

PËRJASHTA

Është e rëndësishme që fëmija ta zhvillojë vetëdijen për sigurinë rrugore. Merrni kohë të mjaftueshme për ta vetëdijesuar fëmijën tuaj lidhur me sjelljet e sigurta përjashta.

- Kujdesuni që fëmijën tuaj ta mbani gjithë kohës për dore.
- Kujdesuni që fëmija juaj të ecën në pjesën e brendshme të trotuarit.
- Gjithmonë kapërcejeni rrugën me fëmijën tuaj në vende të sigurta, në parakalimet për këmbësorë ose pranë shenjave përkatëse.

SHPJEGOJANI DHE FLITINI FËMIJËS TUAJ PËR ÇËSHTJET E SIGURISË

Ndërmerrni veprimtari të ndryshme për ta ngritur vetëdijen e fëmijës suaj për sigurinë, për shembull me libra nga biblioteka ose duke ushtruar daljen nëpër shtigjet e shpëtimit në rast të zjarrit, por mos harroni t'ia bëni të qartë që është fjala vetëm për masa parandaluese.

Për informata dhe këshilla të mëtejme:

The Royal Society for the Prevention of Accidents (RoSPA)

Tel: 0121 248 2000 Faks: 0121 248 2001

E-maili: help@rospa.com www.rospa.com

Child Accident Prevention Trust (CAPT)

Tel: 020 7608 3828 Faks: 020 7608 3674

E-maili: safe@capt.org.uk www.capt.org.uk

Local Fire Authority – Në të shumtën e rasteve, autoritetet lokale të zjarrfikësve do të zhvillojnë kontroll falas të banesës suaj dhe do t'ju ofrojnë pajisje të alarmit në rast zjarri.

Ju lutemi shënojini në vazhdim njoftimet lokale dhe mundësitë e kontaktimit, si për shembull shërbimet e zjarrfikësve, departamentet e parqeve, etj.

Të gjitha të drejtat e rezervuara © Crown, gusht 2006